



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. ____/____Prot.

Fier, më 07.10.2022

Lënda: Formulari i njoftimit paraprak të fituesit për procedurën me objekt “**Blerje pajisje sportive për zhvillimin e ndeshjeve sportive në Pallatin e Sportit të lojrave me dorë**” me burim financimi nga buxheti i Bashkisë Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

Shtojca 10

BASHKIA FIER

Data: 07.10.2022

Drejtuar: Operatorit ekonomik “**B R A T I**” SHPK

Adresa: Tirane Vore GJOKAJ Autostrada Tirane Durres, km 13, Gjokaj

NUIS K51605041E

Procedura e prokurimit: E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike, me objekt “**Blerje pajisje sportive për zhvillimin e ndeshjeve sportive në Pallatin e Sportit të lojrave me dorë**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-41657-09-14-2022**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Blerje pajisje sportive për zhvillimin e ndeshjeve sportive në Pallatin e Sportit të lojrave me dorë**”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **8 459 827** (tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, me

burim financimi nga buxheti i Bashkisë Fier, në përputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **Jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [19 Shtator 2022], [Numri 129].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**ARTEO 2018**” SHPK, numri i NUIS: L82523203F. vlera totale sipas formularit të ofertës është **8,430,000.00** (tetë milion e katërqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH. - afati i dorezimit sipas kërkeses se bere.
2. Operatori ekonomik “**B R A T I**” SHPK, numri i NUIS: K51605041E, vlera totale sipas formularit të ofertës është **8,220,000.00** (tetë milion e dyqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH. - afati i dorezimit sipas kërkeses se bere.
3. Operatori ekonomik “**GRADECI**” SHPK, numri i NUIS: L68714401S vlera totale sipas formularit të ofertës është **8,305,000.00** (tetë milion e treqind e pesë mijë) lekë pa TVSH. - afati i dorezimit sipas kërkeses se bere.
4. Operatori ekonomik “**START CO**” SHPK, numri i NUIS: L11614001S vlera totale sipas formularit të ofertës është **8,150,000.00** (tetë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH. - afati i dorezimit sipas kërkeses se bere.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “**START CO**” SHPK
2. “**GRADECI**” SHPK

Konkretisht për arsyet si me poshte:

- **Operatori ekonomik START CO SHPK me NUIS L11614001S**

Nuk plotëson kriteret sipas DST (shtojca 7), konkretisht:

I. Për plotësimin e kriterit 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **1 300 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

- a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
ose
- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

O.E START CO SHPK ka paraqitur në SPE për plotësimin e këtij kriteri kontratat e mëposhtme:

1. Kontratë nr.697/49 prot., datë 28.07.2021 me objekt “Blerje lodrash në funksion të aktivitetit të lirë të fëmijëve në Çerdhe dhe Kopshte” me Bashkinë Tiranë Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve (**ent publik**) shoqëruar me faturë elektronike me nr. 94/2021 dhe datë 16.09.2021, faturë elektronike me nr. 113/2021 dhe datë 19.10.2021, faturë elektronike me nr. 116/2021 dhe datë 26.10.2021 dhe faturë elektronike me nr.132/2021 dhe datë 11.11.2021.
2. Kontratë nr.862/11 prot., datë 12.06.2020 me objekt “Përditësimi i moduleve, topologjisë dhe analizave për aplikacionet e rrjetit EMS” nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) (**ent publik**).

Në rastin e të 2 (dy) kontratave të sipërcituara, të paraqitura nga O.E. START CO SHPK, referuar objektit të këtyre kontratave dhe përmbajtjes së tyre, këto kontrata nuk vlerësohen kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, dhe për sa më sipër nuk provohet se ky O.E. zotëron eksperiencë të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, referuar kërkesave për kualifikim të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) dhe rregullat e prokurimit publik, ç’ka përbën shkak për skualifikim.

- **Operatori ekonomik GRADECI SHPK me NUIS L68714401S**

Nuk plotëson kriteret sipas DST (shtojca 7), konkretisht:

I. Për plotësimin e kriterit 2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **1 300 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

- a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
ose

- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për përmbushjen e kësaj pike O.E GRADECI SHPK nuk ka paraqitur asnjë dokument, ç'ka përbën shkak për skualifikim. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Për plotësimin e kriterit 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente e saj për objektin që prokurohet (*e cila duhet të jetë e përkthyer në shqip dhe e noterizuar*) e lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Ndërkombëtare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

O.E GRADECI SHPK ka paraqitur në SPE për plotësimin e këtij kriteri Çertifikatën ISO (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) si më poshtë:

1. Çertifikata e cilësisë ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e GRADECI SHPK, Lagjia Çlirim, Rruga Kryesore, godinë me nr. 10 – Çorovodë – Albania (L68714401S) me nr.certifikate I1613548262Q me fushëveprimi: “Kjo Certifikatë është e zbatueshme për vargjet e mëposhtme të produktit ose shërbimeve:Tregti me pakicë e karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Tregti me pakicë e gazit të lëngshëm (GNL).”

Në rastin e certifikatës ISO të paraqitur nga O.E GRADECI SHPK fushëveprimtaria e kësaj çertifikate nuk përpunet me objektin që prokurohet, ç'ka përbën shkak për skualifikim.

*** * ***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**B R A T I**” SHPK, numri i NUIS: K51605041E, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **8,220,000.00** (*tetë milion e dyqind e njëzetë mijë*) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 109 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ZYRTARI I AUTORIZUAR
Zv.Kryetari**

Andius OLLDASHI